

VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Xhezair ZAGANJORI	Kryesues
Ardian DVORANI	Anëtare
Andi ÇELIKU	Anëtar
Arjana FULLANI	Anëtar
Evelina QIRJAKO	Anëtar

Mori në shqyrtim në seancë gjyqësore të datës **21.03.2017**, çështjen administrative që i përket:

PADITËSE: **Katerina Millona;**

I PADITUR: **Instituti i Ndërtimit Tiranë;**

OBJEKTI: Kundërshtimi i masës së pagës së paguar nga i padituri Instituti Ndërtimit për paditësen, që nga data 01.10.2010 dhe pagesa e diferencës së papaguar.
Kërkohet detyrimi i palës së paditur Instituti Ndërtimit Tiranë t'i paguajë paditësit shpërblimin për vjetërsi në punë.
Kërkohet detyrimi i palës së paditur Instituti Ndërtimit të dëmshpërblejë paditësin me pagën e një viti për ndërprerje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

BAZA LIGJORE: Nenet 111, 144, 145, 146, 155 dhe 203 të Kodit të Punës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2135, datë 01.03.2013, ka vendosur:
“Pranimin e padisë së paditëses Katerina Millona. Detyrimin e palës së paditur Instituti i Ndërtimit Tiranë t'i paguajë paditëses Katerina Millona: - vlerën prej 8.100 (tetëmijë e njëqind) lekë në muaj për periudhën që përfshin muajt tetor 2010-dhjetor 2011 si diferenca midis pagës së përfituar nga paditësja dhe pagës që duhej të kishte marrë minimalisht në bazë të VKM nr. 566 dt. 14.07.2010 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, - pagën e një viti si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës së paditëses si arshiviste teknike pranë palës së paditur Instituti i Ndërtimit. - 14 paga mujore si shpërblim për vjetërsi në punë. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur”.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 825, datë 13.03.2014, ka vendosur:
“Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për shqyrtimin e çështjes civile nr. Akti 3676/1236 datë regjistrimi 04.06.2013 si dhe dërgimin e saj për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1454, datë 06.05.2014, ka vendosur:
“Lënien në fuqi të vendimit nr. 2135, datë 01.03.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2135, datë 01.03.2013, ka vendosur: *“Pranimin e padisë së paditëses Katerina Millona. Detyrimin e palës së paditur Instituti i Ndërtimit Tiranë t’i paguajë paditëses Katerina Millona: - vlerën prej 8.100 (tetë mijë e njëqind) lekë në muaj për periudhën që përfshin muajt tetor 2010-dhjetor 2011 si diferenca midis pagës së përfituar nga paditësja dhe pagës që duhej të kishte marrë minimalisht në bazë të VKM nr. 566 dt. 14.07.2010 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, - pagën e një viti si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës së paditëses si arshiviste teknike pranë palës së paditur Instituti i Ndërtimit. - 14 paga mujore si shpërblim për vjetërsi në punë. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur”.*

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 825, datë 13.03.2014, ka vendosur: *“Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për shqyrtimin e çështjes civile nr. Akti 3676/1236 datë regjistrimi 04.06.2013 si dhe dërgimin e saj për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”.*

8. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1454, datë 06.05.2014, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 2135, datë 01.03.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”.*

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr. 1454 datë 06.05.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, më 21.03.2017

Nr. 31003-03862-00-2014 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2017-291 i Vendimit (141)